



| | |
|---|-------------|
| REPUBLIKAE KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | DPK IDPKI |
| Dep. | 03-02-19417 |
| Nr. Ifaq. | |
| Broj stranica | 02 |
| Nr. pages | |
| Date | |
| Datum | 27.01.2017 |
| Date | |
| PRISHTINE | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-02-2770/16, për z. Bekim Avdiu – Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtërpçës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-2770/16, për z. Bekim Avdiu – Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtërpçës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Avdiu, është hetuar për konflikt interesit sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat “Mini Ferma”.

Fillimisht ai është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Avdiu është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Avdiu, ka deklaruar se e ka mbylluar biznesin, gjë që është dëshmuar edhe me shkresë zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPK 03-02-4873/16) me të cilën vërtetohet se ai, vullnetarisht ka mbyllur biznesin privat “Mini Ferma”. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK-së;
- Z./z. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shap Havollli

